



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 231, datë 02.06.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË GJYKATËN E APELIT DURRËS, PËR POZICIONET E LIRA
TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 174, DATË 28.05.2020 DHE NR. 392,
DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe të së drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr.174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska, si relator për këto procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR